

VENDIM

NR. 4 DATE /07/ 09/ 2022

I ORTAKUT TE VETEM

TE SHOQERISE “ HASTOÇI “ SH.P.K

TIRANE

Sot me **date / 07 / 09 / 2022**, ne Seline e shoqerise “**HASTOÇI “ SH.P.K TIRANE** u zhvillua mbledhja e **ORTAKUT TE VETEM te SHOQERISE** ,per emerimin e Audituesit Ligjor per hartimin e Raportit per Zmadhim te Kapitalit aksionar, nepermjet “ **Rezerva per Investime** ”, dhe “ **Fitimit te Ushtrimit 2021** “ ,gjendje me **31.12.2021**, dhe ne perfundim :

VENDOSI:

- Caktimin e **zj. Engjellushe RAMI** , anetare e **I.E.K.A** , me profesion Auditues Ligjor ,me license **Nr. 259. date 27/08/2012**, per vleresimin e zmadhimit te Kapitalit Aksionar nepermjet “ **Rezerva per Investime** “ dhe “**Fitimit te ushtrimit 2021**” , gjendje me **31.12.2021**.
- Depozitimin e ketij vendimi ne **Q.K.B** .

**ORTAKU I VETEM
(Asllan HASTOÇI)**



SHOQERISE "HASTOÇI" SH.P.K TIRANE

RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

PER ZMADHIM KAPITALI

Ekspert Kontabel i Rregjistruar
ENGJELLOSHE RAMI
P.E. Nr. 259

ORTAKUT TË VETËM
TË SHOQËRISË “HASTOÇI” SH.P.K TIRANE
SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR
PËR ZMADHIM KAPITALI TË SHOQËRISË
“HASTOÇI” SH.P.K TIRANE

Me cilësinë e **AUDITUESIT LIGJOR**, i caktuar dhe miratuar nga **ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË “HASTOÇI” SH.P.K TIRANE**, me vendimin Nr.4 datë **07/09/2022**, për hartimin e raportit mbi zmadhimin e kapitalit të shoqërisë **“HASTOÇI” SH.P.K TIRANE**, si dhe në zbatim të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, neni 145, pika 1, Neni 168, pika 1, Neni 169, pika 1, neni 177, pika 1 dhe 2, neni 178 pika 1 dhe 2, ju paraqes raportin tim sa më poshtë vijon :

Shoqëria **“HASTOÇI” SH.P.K TIRANE**, me Nipt: **J62028009B**, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me kapital aksionar **271 550 000** (dyqind e shtatedhjetë e nje milion e peseqind e pesedhjetë mijë) lekë, me ortakë të vetëm **z. Asllan HASTOÇI**, i cili zotëronë **100%** të kapitalit aksionar. Perfaqesues ligjor i shoqërisë është **z. Mynyr HASTOÇI**.

Në zbatim të misionit të ngarkuar nga **ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË**, me vendimin e cituar më lartë, u shqyrtuan dhe u kryen verifikimet e nevojshme konformë rregullave të profesionit dhe dispozitave ligjore në fuqi.

Sipas vendimit të **ORTAKUT TË VETËM** të kësaj shoqërie, Nr. 4 datë **07/09/2022**, është vendosur rritja e kapitalit aksionar në **masën 73 000 000** (shtatedhjetë e tre milion) lekë.

Rritja e kapitalit do të bëhet, nga përfshirja në kapital e **“Rezerva per Investime”**, në vlerën **33 000 000** (tridhjetë e tre milion) lekë dhe e **“Fitimit neto të vitit 2021”** në vlerën **40 000 000** (dyzetë milion) lekë, pasi janë zbritur rezervat ligjore.

“Rezerva per Investime” dhe **“Fitimi Neto i vitit 2021”**, sipas vlerave të mësipërme, janë të evidentuara saktësisht dhe rezultojnë gjendje në Bilancin kontabël me datë **31/12/2021**.

Gjithsej rritja e kapitalit do të jetë 73 000 000 lekë.



Nga testet dhe verifikimet përkatëse që kam bërë , rezulton se vlerat e “ **Rezerva per Investime**” dhe “**Fitimi Neto i vitit 2021**“ të shoqërisë “**HASTOÇI**” SH.P.K TIRANE, janë të evidentuar saktësisht në bilancin kontabël të ushtrimit 2021.

Për vlerësimin për rritjen e kapitalit jam mbështetur në bilancin kontabël të ushtrimit 2021, bilanc në të cilin janë evidentuar saktësisht në llogarië përkatëse vlerat respektive me anën e të cilave do të bëhet zmadhimi i kapitalit , si dhe në dokumenta te tjera të vëna në dispozicion nga ana e shoqërisë sic janë :Inventarët e pasurisë,analizat e llogarive ...etj.

Si përfundim:

-Kapitali aksionar i shoqërisë “**HASTOÇI**” SH.P.K TIRANE ,pas këtij zmadhimi do të jetë si me poshtë vijon :

- Kapitali aksionar i regjistruar	271.550.000 lekë
- Shtesa si pasoj e Zmadhimit te kapitalit	73.000. 000 leke
- Kapitali Aksionar pas zmadhimit	<u>344.550. 000 leke</u>

Në zbatim të ligjit Nr.9901 datë14.04.2008 “Per Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” neni 145, pika 1, neni 177, pika 1 dhe 2, për zmadhimin e kapitalit , si dhe të vendimit përkatës të **ORTAKUT TË VETËM** te Shoqërisë “**HASTOÇI**” SH.P.K TIRANE , shuma prej **344.550. 000 leke** (treqind e dyzete e kater milion e peseqind e pesedhjete mije) lekë , është e argumentuar dhe e sistemuar sipas rregullave të mbajtjes së kontabilitetit financiar duke u paraqitur në postet e dhura të bilancit të reformuar të kësaj shoqërie .

Llogaritë qe janë prekur si rezultat i zmadhimit të kapitalit aksionar si më sipër jane : llogaria 101,107 , dhe llogaria 109.

Operacioni i zmadhimit të kapitalit të shoqërisë “**HASTOÇI**” SH.P.K TIRANE i propozuar dhe i miratuar nga **ORTAKU I VETËM** i Shoqërisë, është i motivuar nga legjislacioni në fuqi dhe i justifikuar financiarisht.

Pas shqyrtimit të sipërpërmendur të dokumentave financiare e kontabël, kapitali i përcaktuar prej **344.550. 000** (treqind e dyzete e kater milion e peseqind e pesedhjete mije) **leke** ,i përgjigjet vlerës së aktivitetit neto të shoqërisë.

Tiranë më /12/09/2022

AUDITUES LIGJOR
ENGJELLUSHE RAMI



VENDIM
NR. 5 DATE / 16 / 09 / 2022
I ORTAKUT TE VETEM
TE SHOQERISE “HASTOÇI “ SH.P.K
TIRANE

Sot me date 16/09/2022, ne seline e shoqerise “**HASTOÇI “ SH.P.K TIRANE** u zhvillua mbledhja e **ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE** , rendi i dites te se ciles eshte , shqyrtimi i raportit te paraqitur nga **Audituesi ligjor** ,per Rritjen e Kapitalit Aksionar te shoqerise nepermjet “ **Rezerva per Investime “ dhe “ Fitimit te ushtrimit 2021 “** ,
gjendje ne 31.12.2021.

Dhe ne perfundim **ORTAKU I VETEM I SHOQERISE “HASTOÇI “ SH.P.K TIRANE**

V E N D O S I :

- Miratimin e raportit te Audituesit ligjor **zj. Engjellushe RAMI.**
- Zmadhimin e Kapitalit Aksionar te shoqerise sipas menyres se percaktuar ne raportin e Audituesit Ligjor.
- Zmadhimin e Kapitalit Aksionar te shoqerise “**HASTOÇI “ SH.P.K TIRANE** nga **271 550 000** (dyqind e shtatedhjete e nje milion e peseqind e pesedhjete mije) **leke** , ne , **344 550 000** (treqind e dyzete e kater milion e peseqind e pesedhjete mije) **leke** .
- Depozitimin e ketij vendimi prane Q.K.B –s Tirane.

ORTAKU I VETEM
(Asllan HASTOÇI)

